



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KUVENDI

**PROJEKTLIGJ**

Nr. \_\_\_\_\_/2024

**“PËR**

**DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 133/2015 “PËR TRAJTIMIN E PRONËS DHE PËRFUNDIMIN E PROCESIT TË KOMPENSIMIT TË PRONAVE”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të neneve 78, 81, pika 1 dhe 83, pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë

**V E N D O S I:**

Në ligjin nr.133/2015 “Për trajtimin e pronës dhe përfundimin e procesit të kompensimit të pronave”, të ndryshuar, bëhen ndryshimet e mëposhtme:

**Neni 1**

Në pikën 1, të nenit 11, togfjalëshi “në 10 vjet” zëvendësohet me togfjalëshin “deri në vitin 2028”.

**Neni 2**

Në pikën 1, të nenit 15, togfjalëshi “brenda datës 31.12.2024” zëvendësohet me togfjalëshin “brenda datës 31.12.2027”.

**Neni 3**

Në pikën 6, të nenit 16, togfjalëshi “brenda një afati prej 10 vitesh nga momenti i hyrjes në fuqi të këtij ligji.” zëvendësohet me togfjalëshin “deri më 31.12.2028.”.

**Neni 4**

Në pikën 1, të nenit 34, togfjalëshi “brenda datës 31.12.2024” zëvendësohet me togfjalëshin “brenda datës 31.12.2027”.

## **Neni 5**

Në tabelën që pasqyrohet në Shtojcën 2, të ligjit nr.133/2015, të ndryshuar, kolona “viti 10” zëvendësohet me kolonat e mëposhtme:

<b>viti 10</b>	<b>viti 11</b>	<b>viti 12</b>	<b>viti 13</b>
5,3	5,3	5,3	7,63

## **Neni 6**

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI**

**ELISA SPIROPALI**